



INFORMATË BAZIKE:

Observeri i Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Serbe dhe Ruse është një raport analitik tremujor për lajmet që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e kanë në shënjestër Kosovën të botuara nga mediat që origjinën e kanë në Serbi dhe Rusi.

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbretëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave

Tel: +383 (0)38 542 778

Web-site: www.kipred.org

Email: info@kipred.org

OBSERVERI I DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE DHE SERBE


Janar - Mars 2020

Përmbledhje Ekzekutive


Observeri i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Serbe dhe Ruse është një raport tremujor që synon t'i analizojë trendet dezinformuese të lajmeve të botuara në publikimet e përzgjedhura mediale në gjuhët angleze dhe serbe, që origjinën e kanë në Serbi dhe Rusi dhe që e vejnë në shënjestër Kosovën.

Mediat e përzgjedhura që origjinën e kanë në Serbi dhe që janë të njohura për botimin e lajmeve me përmbajtje dezinformuese janë Tanjug, Informeri, Novosti, Kuriri, B92-shi, Politika dhe Naša Borba, ndërkaq, mediat e përzgjedhura përkatëse që origjinën e kanë në Rusi janë Russia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran dhe Pravda Report, dhe këtu janë marrë edhe dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën të botuara nga Kremli dhe Ministria Ruse e Punëve të Jashme.


Monitorimi i të dhënave tregon se që nga 1 janari e deri më 31 mars 2020, publikimet mediale që origjinën e kanë në Serbi kanë botuar 1.083 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. Tanjugu i ka botuar 193, Informeri 188, Novosti 205, B92-shi 193, Kuriri 53, Politika 182, dhe Naša Borba 69 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën.




Trendet dezinformuese për mediat serbe tregojnë që vlera më e lartë në përqindje e raportit lajme/lajme me dezinformata, ka qenë në janar 2020, dhe atë 12,40%, e vijuar nga 7,80% në shkurt, dhe me 5,21% në mars 2020.



Monitorimi i të dhënave tregon se që nga 1 janari e deri më 31 mars 2020, publikimet mediale që e kanë patur origjinën në Rusi i kanë botuar 337 lajme që drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë patur të bëjnë me Kosovën. Sputnik – Publikimi në Serbisht i ka botuar 297, Sputnik International 4, Russia Today 11, Russia Insider 4, Meduza asnjë, TASS-i 5, Moscow Times asnjë, Pravda Report asnjë, Newsfront 8, UNZ-i 2, Durani 1 dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Rusisë 5 lajme, që drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë qenë të ndërlidhur me Kosovën.



Trendet dezinformuese të mediave ruse tregojnë që vlera më e lartë në përqindje e raportit lajme/lajme me dezinformata, ka qenë për muajin mars 2020, dhe atë 12,40%, e vijuar me 11,76% në janar, ndërkaq, vlera më e ulët në përqindje e këtij raporti ka qenë 3,47%, për muajin shkurt 2020.



Dekonstruktimi i lajmeve që origjinën e kanë patur në Serbi dhe që i kanë përmbajtur dezinformatat më flagrante (19 lajme) të botuara gjatë kësaj periudhe nga mediat e përzgjedhura të sipërpërmendura,¹ tregon që dezinformatat kanë qenë të përqendruara në shkatërrimin e themeleve të legalitetit dhe legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës përmes:

- Projektimit të Kosovës si një shtet problematik, dhe diskreditimit të NATO-s, duke e akuzuar atë për përkushtimin ndaj krimeve të tmerrshme kundër Serbisë.
- Paraqitjes së Kosovës si një shtet që i shtyp komunitetet e veta etnike pakicë, dhe përmes paraqitjes së rrejshme të numrit të refugjatëve serbë që e kanë braktisur Kosovën pas luftës;
- Mohimit të krimeve të luftës të kryera nga forcat e armatosura serbe gjatë konfliktit 1998 – 1999, dhe;
- Diskreditimit të udhëheqësisë dhe të institucioneve të sigurisë së Kosovës, si dhe të ndihmës së dhënë nga vendet perëndimore.

Nga ana tjetër, dekonstruktimi i lajmeve që origjinën e kanë patur në Rusi dhe që i kanë përmbajtur dezinformatat më flagrante (10 lajme) të botuara gjatë kësaj periudhe nga mediat e përzgjedhura të sipërpërmendura,² tregon që dezinformatat kanë qenë të përqendruara në shkatërrimin e themeleve të legalitetit dhe legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës përmes:

- Paraqitjes së Kosovës si kërcënim për sigurinë ndërkombëtare dhe rajonale;
- Paraqitjes së Kosovës si një krijesë shtetërore që është krijuar përmes një “gjenocidi” të përkrahur nga vendet perëndimore kundër popullatës së saj serbe;
- Akuzimit të Kosovës dhe NATO-s për krime lufte kundër popullatës serbe, dhe ekzagjerimit të numrit të viktimave serbe gjatë Luftës së Kosovës;

¹ KIPRED, Lajmëruesit e Dezinformatave për Kosovën: Mediat Serbe, Janar – Mars 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Serbian Media - January 2020 559714.pdf>, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - February 2020.docx 781033.pdf>, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - March 2020-Eng.docx 864184.pdf>

² Lajmëruesit e Dezinformatave për Kosovën: Mediat Ruse, Botimet Janar – Mars, 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - January 2020.docx 381824.pdf>, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - February 2020.docx 463885.pdf>, dhe <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - March 2020 Eng 568615.pdf>

- Paraqitjes së Kosovës si një shtet që i shtyp komunitetet e veta pakicë, dhe që ka një potencial të lartë për të shpërthyer në dhunë etnike;
- Mohimit të krimeve të kryera nga Serbia në Kosovë;
- Bërjes së krahasimeve të rrejshme të shtetësisë së Kosovës me aneksimin e Krimesë nga Rusia.


Prandaj, mund të përfundohet që lajmet me përmbajtje dezinformuese që kanë të bëjnë me Kosovën, të botuara nga mediat me origjinë në Serbi dhe në Rusi, kanë qenë shumë të ngjashme, nëse jo edhe të njëjta. Që të dyja grupet e lajmeve synonin në shkatërrimin e themeleve të legjitimitetit dhe legalitetit të shtetësisë së Kosovës, me një dallim të vogël që mediat ruse, pos qëllimeve që i kishin mediat serbe, e shtonin edhe krahasimin e shtetësisë së Kosovës me aneksimin e Krimesë.

Analizat në vijim do t'i paraqesin të dhënat statistikore mujore për raportet lajme/dezinformata për publikimet e përzgjedhura mediale që origjinën e kishin në Serbi dhe Rusi, dhe këto do të ofrojnë po ashtu analiza të shkurtëra për përqendrimet dhe synimet e dezinformatave të botuara, bazuar në analizat e dezinformimeve të botimeve të janarit, shkurtit dhe marsit të Lajmëtarëve të Dezinformatave për Kosovën të Mediave Serbe dhe Ruse.

Lajmet dhe Dezinformatat

Janar 2020


Monitorimi i të dhënave për mediat serbe tregon se nga data 1 deri më 31 janar, 2020, Tanjugu ka botuar 45, Informeri 31, Novosti 44, B92-shi 49, Kuriri 11, Politika 50, dhe Naša Borba 20 lajme të ndërlidhura drejtpërdrejt apo tërthorazi me Kosovën. Nga këto 250 lajme të botuara në këto publikime mediale, 31 kishin përmbajtje dezinformuese.



Dekonstruktimi i lajmeve që përmbanin dezinformatat më flagrante (6 lajme) të botuara në janarin 2020 tregon që dezinformatat kanë qenë të përqendruara në mohimin e krimeve të luftës të kryera nga forcat e armatosura serbe në Kosovë gjatë konfliktit 1998–1999, në diskreditimin e udhëheqësisë dhe të institucioneve të sigurisë së Kosovës, si dhe të ndihmës së ofruar Perëndimore, në projektimin e Kosovës dhe Malit të Zi si shtete problematike, dhe në paraqitjen e përkrahjes nga BE-ja të bashkëpunimit ndërkufitar rajonal midis Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë, si një përkrahje që Mali i Zi ia jep krijimit të fantazmës së “Shqipërisë së Madhe.”³

³ Lajmërues i Dezinformatave për Kosovën: Mediat Serbe, Botimi i Janarit, KIPRED 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Serbian Media - January 2020 559714.pdf>

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave për mediat ruse tregon se nga 1 deri më 31 janar 2020, Sputnik Serbia i ka botuar 62, Sputnik International 1, Russia Today 2, Russia Insider 1, Meduza asnjë, TASS 1, The Moscow Times asnjë, Pravda Report asnjë, Newsfront asnjë, UNZ asnjë, Durani asnjë, dhe Ministria e Jashme Ruse 1 lajm, që drejtpërdrejt apo tërthorazi kishin të bënin me Kosovën. Nga këto 68 lajme të botuara nga këto publikime mediale, përmbajtje dezinformuese kishin 8 sosh.




Dekonstruktimi i lajmeve me dezinformata të lëshuara në janar 2020 nga mediat e përzgjedhura ruse dhe Ministria Ruse e Punëve të Jashme lidhur me Kosovën e tregon përqendrimin e tyre në shkatërrimin e themeleve të legjitimitetit dhe legalitetit të shtetësisë së Kosovës dhe të përkrahjes së vendeve Perëndimore. Kjo bëhet përmes paraqitjes së Kosovës si një krijesë shtetërore që është krijuar përmes një “gjenocidi” kundër popullatës së vet serbe, të përkrahur nga vendet perëndimore, përmes mohimit të krimeve të luftës të kryera nga Serbia në Kosovë, përmes bërjes së krahasimeve të gabuara të shtetësisë së Kosovës me aneksimin e Krimesë nga Rusia, dhe përmes paraqitjes së Kosovës si një kërcënim për sigurinë rajonale.⁴

⁴ Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Mediat Ruse, Botim i Janarit, KIPRED 2020, http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - January 2020.docx_381824.pdf

Lajmet dhe Dezinformatat Shkurt 2020

Monitorimi i të dhënave të mediave serbe tregon se nga data 1 deri më 29 shkurt 2020, Tanjugu i ka botuar 74, Informeri 84, Novosti 87, B92-shi 77, Kuriri 30, Politika 70, dhe Naša Borba 27 lajme që drejtpërdrejt apo tërthorazi kishin të bënin me Kosovën. Nga këto 449 lajme të botuara nga këto publikime mediale, 35 kishin përmbajtje dezinformuese.




Dekonstruktimi i lajmeve që përmbanin dezinformatat më flagrante (5 lajme) të botuara në shkurtin 2020 tregon që dezinformatat kanë qenë të përqendruara në mohimin e krimeve të luftës të kryera nga forcat e armatosura serbe gjatë konfliktit të viteve 1998–1999, në paraqitjen e numrit të gabuar të refugjatëve serbë që e braktisën Kosovën pas luftës, në diskreditimin e udhëheqësisë dhe të institucioneve të sigurisë së Kosovës, si dhe të ndihmës së dhënë Perëndimore, dhe në projektimin e Kosovës dhe të Malit të Zi si shtete problematike.⁵

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave për mediat ruse tregon se nga data 1 deri më 29 shkurt, 2020, Sputnik Serbia i ka botuar 132, Sputnik International 1, Russia Today 5, Russia Insider 2, Meduza asnjë, TASS 1, The Moscow Times asnjë, Pravda Report asnjë, Newsfront asnjë, UNZ

⁵ Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Mediat Serbe, Botimi i Shkurtit, KIPRED 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - February 2020.docx 781033.pdf>

asnjë, Durani asnjë, dhe Kremli e Ministria e Jashtme Ruse 3 lajme që drejtpërdrejt apo tërthorazi ishin të ndërlidhura me Kosovën. Nga këto 144 lajme të botuara në këto publikime mediale, përmbajtje dezinformuese kishin 5 sosh.




Dezinformatat e botuara nga burimet ruse të lajmeve, përfshirë këtu edhe Ministrinë Ruse të Punëve të Jashtme, synojnë ta paraqesin një pamje të paqartë të pozitës së komunitetit serb dhe të gjendjes ndër-etnike në Kosovë. Kjo bëhet me qëllim që Kosova të paraqitet si një shtet që i shtyp komunitetet etnike pakicë, me një potencial të lartë të dhunës etnike, dhe që t’ia shkatërrojnë themelet, si legjitimitetit, ashtu edhe legalitetit, të shtetësisë së Kosovës dhe të përkrahjes Perëndimore për të.⁶

⁶ Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Mediat Ruse, Botimi i Shkurtit, KIPRED 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - February 2020.docx> 463885.pdf

Lajmet dhe Dezinformatat

Mars 2020

Monitorimi i të dhënave për mediat serbe tregon se nga data 1 deri më 31 mars 2020, Tanjugu i ka botuar 74, Informeri 73, Novosti 74, B-92-shi 67, Kuriri 12, Politika 62, dhe Naša Borba 22 lajme që drejtpërdrejt apo tërthorazi kishin të bënin me Kosovën. Nga këto 384 lajme të botuara në këto publikime mediale, 20 kishin përmbajtje dezinformuese.




Dekonstruktimi i lajmeve që përmbanin dezinformatat më flagrante (8 lajme) të botuara në marsin 2020 tregon që dezinformatat kanë qenë të përqendruara në shkatërrimin e themelit të legjitimitetit dhe legalitetit të shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës përmes diskreditimit të udhëheqësisë dhe të institucioneve të saj të sigurisë, si dhe përmes paraqitjes së Kosovës si një shtet që i shtyp pakicat e veta etnike. Artikujt e përzgjedhur përpiqeshin po ashtu që t'ia shkatërronin themelet përkrahës së Perëndimit për Kosovën, dhe ta diskreditonin NATO-n, duke e akuzuar atë për kryerjen e krimeve të tmerrshme kundër Serbisë.⁷

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave për mediat ruse tregon se nga data 1 deri më 31 mars 2020, Sputnik Serbia i ka botuar 103, Sputnik International 2, Russia Today 4, Russia Insider 1,

⁷ Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Mediat Serbe, Botimi i Marsit, KIPRED 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - March 2020-Eng.docx> 864184.pdf

Meduza asnjë, TASS 3, The Moscow Times asnjë, Pravda Report asnjë, Newsfront 8, UNZ 2, Durani 1, dhe Kremli e Ministria e Jashtme Ruse 1 lajm, që drejtpërdrejt apo tërthorazi kishin të bënin me Kosovën. Nga këto 125 lajme të botuara nga këto publikime mediale, përmbajtje dezinformuese kishin 17 sosh.



Dezinformatat e krijuara gjatë kësaj periudhe nga mediat e përzgjedhura ruse në raport me Kosovën janë të përqendruara në shkatërrimin e themeleve të legjitimitetit dhe legalitetit të shtetësisë së Kosovës dhe në diskreditimin e kredibilitetit të aleancës së NATO-s. Duke e bërë këtë, këto media i mohojnë krimet e luftës të kryera nga Serbia në Kosovë, ato e akuzojnë Kosovën dhe NATO-n për krimet e luftës kundër popullatës serbe, dhe e ekzagjerojnë numrin e viktimave serbe.⁸

⁸ Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Mediat Ruse, Botimi i Marsit, KIPRED 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - March 2020 Eng 568615.pdf>